



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr 2848 Prot.

Ballsh, më 17.06.2025

**SHPLLJE PER VENDE TË LIRA PUNE
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE**

**PUNËTOR PASTRIMI I MBETJEVE URBANE,
SEKTORI I PASTRIM-GJELBËRIMIT,
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, BASHKIA MALLAKASTËR.**

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, mbështetur dhe në Ligjin 115/2014 “Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore”, Ligjin 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar Vendimin Nr.04 datë 30.12.2024 “Për miratimin e strukturës, organikës, kategoritë/klasat e pagave për punonjësit e Bashkisë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe të deleguara për vitin 2025, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Mallakastër shpall vende të lira pune:

-Punëtor Pastrimi i Mbetjeve Urbane, Sektori i Pastrim-Gjellbërimit, 2 (dy) pozicione.

➤ **Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës;**

-Të kryejë pastrimin dhe grumbullimin e mbetjeve urbane në zonat e caktuara, duke kontribuar në ruajtjen e pastërtisë publike dhe mbrojtjen e mjedisit sipas rregullave të përcaktuara nga Sektori i Pastrim-Gjellbërimit.

Detyrat dhe Përgjegjësitë Kryesore:

- Grumbullimi i mbetjeve të ngurta urbane nga koshat dhe zonat e dedikuara.
- Zbraza e kosheve dhe kontejnerëve në automjetet e mbeturinave.
- Ndiurma në mirëmbajtjen dhe pastrimin e automjeteve të mbeturinave.
- Sigurimi që mbeturinat të hidhen sipas rregulloreve dhe protokolleve të riciklimit ose asgjësimit.
- Raportimi i menjëhershëm i çdo problemi ose ndotjeje të jashtëzakonshme tek mbikëqyrësi.

- Përdorimi i mjeteve të punës (fshesë, lopatë, karroca, etj.) në mënyrë të sigurt dhe efikase.
- Respektimi i rregullave të sigurisë dhe mbrojtjes në punë

Kualifikimet dhe Kërkesat:

- Arsim i mesëm (ose 9-vjeçar).
- Përvojë e mëparshme në pastrim ose sektorë të ngjashëm është avantazh.
- Aftësi për të punuar në kushte të jashtme dhe në orare fleksibile.
- Fizikisht i aftë për të kryer punë të rëndë fizike.
- Ndjenjë përgjegjësie dhe përkushtim ndaj pastërtisë publike.
- Respektim i etikës së punës dhe bashkëpunim në ekip.

➤ -Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati I Dorëzimit

-Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Fotokopje e kartës së identitetit;
2. Saktësim adrese;
3. Certifikatë familjare;
4. Një kopje të jetëshkrimit (CV);
5. Një numër kontakti (e-mail) si dhe adresën e plotë të vendbanimit;
6. Fotokopje dëftese pjekurie;
7. Raport mjeko-ligjor nga autoriteti kompetent, që vërteton "gjëndje të mirë shendetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra";
8. Vërtetim i gjendjes Gjyqësore (Dëshmi Penaliteti)/Formular vetëdeklarimi;
9. Fotokopje të librezës së punës e njëzuar me origjinalin (nëse ka);

➤ Aplikimi dhe dorëzimi I dokumentave bëhet pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mallakastër ,brenda datës 27.06.2025.

-Mënyra e Vlerësimit të Kandidatëve;

Kandidatët të cilët kanë aplikuar në këto pozicione pune do t'ju shqyrtohen dokumentacionet e dërguara në Sektorin i Burimeve Njerezore dhe do të njoftohen për pranimin ose jo në këto pozicione pune.

Sektori i Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mallakastër do të shpallë fituesit , në faqen e internetit të Bashkisë Mallakastër dhe stendat e informimit të publikut.

BASHKIA MALLAKASTËR
NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

LAURETA SALIAJ

JONIDA LLAKA

MERUSHE QALLIAJ

